



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 21.23.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË SË  
DIASPORËS  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Diasporës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Riza Spanca (Udhëheqës ekipi), Florë Berisha dhe Hysen Restelica (Anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Arvita Zyferi.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	21
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	22
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	25
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	27

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë së Diasporës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 04/11/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Diasporës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i kualifikuar


Sipas opinionit tonë, përveç çështjes se keq deklarimit të shpenzimeve për subvencione në vlerë prej 38,456€, të cilat janë paguar dhe raportuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e Menaxhmentit të MeD-së - auditimi 2016**

Menaxhmenti i MeD-së ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), të Ministrisë së Diasporës (MeD) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinion i kualifikuar

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Diasporës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

### Baza për opinion të kualifikuar

Me qëllim të përkrahjes së organizimeve të ndryshme, MeD kishte ekzekutuar 10 pagesa në vlerë totale 38,456€. Këto lloje të pagesave në substancë i takonin kategorisë së subvencioneve (Neni 36, i Rregullës Financiare nr.01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike), megjithatë ishin paguar dhe raportuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto mangësi i kishte prezantuar tek menaxhmenti edhe Zyrtari Çertifikues, por menaxhmenti i kishte konsideruar si organizime të rëndësishme për diasporën dhe kishte vazhduar me aprovim. Vlen të theksohet se MeD kishte bërë përpjekje për rritjen e buxhetit në kategorinë e subvencioneve me qëllim të përmbushjes së objektivave të Ministrisë që lidhen direkt me aktivitetet për diasporën, mirëpo kjo kërkesë nuk ishte aprovuar nga MF.

Keq deklarimet e prezantuara kanë ndikuar në mbivlerësimin e mallrave dhe shërbimeve dhe nënvlerësimin e subvencioneve.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga MeD dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të**

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Diasporës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

---

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MeD-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

## 1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipërpërmendur të baza për opinion ne japim rekomandimin si në vijim:

**Rekomandimi 1** Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë e detajuar për përcaktimin e shkaqeve për Kualifikimin e Opinionit. Në këtë aspekt, duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet lidhur me keq deklaratimet e shpenzimeve, për të siguruar një buxhetim të drejtë sipas kategorive ekonomike. Me tutje, menaxhmenti duhet të bëjë një rishikim detaj të draft PVF-ve, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.



---

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Ministrinë e Diasporës (MeD), që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, Pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MeD-së, veçanërisht në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, si dhe me menaxhimin e rrezikut, ku mangësitë në identifikimin, vlerësimin dhe analizën e rreziqeve vështirësojnë arritjen e objektivave.

Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga MeD, nuk e pasqyron këtë situatë plotësisht. Aranzhimet e dobëta të qeverisjes vështirësojnë arritjen e objektivave strategjike dhe operative, dhe në këtë mënyrë dobësojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefektive dhe joefektive.

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2015 të MeD-së ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime kryesore. MeD kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në kohën sa ishim në auditim, dy (2) rekomandime ishin zbatuar, katër (4) ishin në proces të zbatimit, kurse tri (3) të tjera ende nuk ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se zbatimit të tyre, shihni Shtojcën III.

### Çështja 2 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Përkundër angazhimit të menaxhmentit në përgatitjen e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, niveli i zbatimit të tyre ishte shumë i ulët. Pjesa më e madhe e rekomandimeve janë në proces të zbatimit ose kanë mbetur të pazbatuara. Kjo pasqyron mungesën e angazhimit të menaxhmentit për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe që pengesat për veprim identifikohen dhe adresohen me kohë. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësimin e vazhdueshëm në të gjithë organizatën. Si pasojë e kësaj, çështjet e njëjta janë përsëritur edhe këtë vit.

**Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të ndikojë në dobësi në menaxhim dhe raportim të shpenzimeve.

**Rekomandimi 2** Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve është duke u monitoruar rregullisht dhe do të zbatohet në përputhje me afatet e përcaktuara kohore. Në fokus parësor duhet të jenë rekomandimet që prekin fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

## 2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një pyetësor të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të saj. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MeD-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo ka për qëllim të mbështesë përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

### Çështja 3 – Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

- E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Bazuar në këtë ne kemi gjetur se:
1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur nga MeD. Kjo për shkak të mungesës së trajnimeve të zyrtarëve të MeD-së në lidhje me hartimin e regjistrit të rreziqeve bazuar në rregulloren për MFK-në; dhe
  2. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) konsiderohen si të vendosura nga MeD, mirëpo vëreheshin dobësi në procesin e monitorimit të zbatimit të saj për shkak të mangësive në raportet e ofruara nga udhëheqësit e njësive.
- Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes vështirësojnë arritjen e objektivave strategjike dhe operative, dhe në këtë mënyrë dobësojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të negociojë me MF, lidhur me trajnimin e zyrtarëve të involvuar në procesin e hartimit të regjistrit të rreziqeve, brenda një afati sa më të shkurtër kohor. Në këtë mënyrë do të finalizohet një regjistër më cilësor i menaxhimit të rrezikut, duke lehtësuar edhe procesin e monitorimit të tij. Poashtu, një rishikim rigoroz duhet të zbatohet për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit për të siguruar se është bërë adresimi i fushave me dobësi. Duhet të aplikohet një mekanizëm formal për ta konfirmuar saktësinë e vlerësimeve të dhëna në listën kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MeD operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Nga rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në këtë fushë, mund të konkludojmë se menaxhmenti ka vendosur një strukturë organizative adekuate, kishte bërë delegimin e detyrave dhe përgjegjësive dhe ishte informuar për proceset e zhvilluara në kuadër të ministrisë.

Departamentet dhe divizionet përgatitin raporte të rregullta në drejtim të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili po ashtu organizon takime pune të rregullta me udhëheqësit e njësive.

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Për një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera, dhe se ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

MeD nuk e ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe si rrjedhojë menaxhmentit i ka munguar siguria e mjaftueshme në lidhje me funksionimin e kontrolleve.

---

### Çështja 4 - Mungesa e themelimit të NJAB – Prioritet i lartë

**E gjetura** MeD, ende nuk e themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB), dhe rrjedhimisht nuk e ka themeluar as Komitetin e auditimit, megjithëse kjo ishte rekomanduar edhe në raportin e vitit 2014 nga AP-ja. Për shkak të mungesës së auditimit të brendshëm menaxhmentit nuk i është ofruar siguri e mjaftueshme në lidhje me funksionimin efikas të kontrolleve të brendshme.

Megjithatë, me kërkesë të MeD-së, Departamenti i Auditimit të Brendshëm në kuadër të MF-së ka kryer një auditim për vitin 2016.

**Rreziku** Mungesa e Sistemit të Auditimit të Brendshëm zvogëlon marrjen e sigurisë nga ana e menaxhmentit në lidhje me operimin e sistemeve të kontrolleve të brendshme, dhe zvogëlon cilësinë e menaxhimit financiar.

**Rekomandimi 4** Ministri duhet të siguroj themelimin e NJAB-së, e cila përmes një programi gjithëpërfshirës të punës do të inkorporonte rreziqet financiare dhe do të vlerësonte efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Përveç kësaj, ne rekomandojmë që të themelohet edhe një Komitet efektiv i Auditimit i cili duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet dhe rezultatet e NJAB-së.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces relativisht të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Edhe në vitin 2016 sikurse në vitin paraprak, MeD kishte arritur të realizoj komplet buxhetin e saj. Kjo paraqet një performancë të mirë buxhetore. Në kontekst të sistemeve financiare, pasuritë dhe obligimet ishin menaxhuar në pajtueshmëri me legjislacionin.

Megjithatë, edhe përkundër kontrolleve të identifikuar në fushat e lartcekura, nevojiten veprime shtesë për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin. Kjo përshinë kryesisht pajtueshmërinë me legjislacionin në menaxhimin e shpenzimeve.

Shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit ishin të mbi shpenzuara në raport me buxhetimin e tyre. Shpenzimet për fushatën sensibilizuese të regjistrit të diasporës dhe mërgatës janë realizuar pa procedura të prokurimit. Për më tepër e gjithë pagesa e tyre ishte bërë në avans. Kjo mund të shkaktojë pa siguri të mjaftueshme nëse marrëveshjet do të realizohen.

Ndërsa, nga aspekti i rëndësisë me të ulët ne identifikuan parregullsi edhe në menaxhimin e subvencioneve si dhe në menaxhimin e personelit.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MeD si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,606,803</b>	<b>1,755,509</b>	<b>1,752,549</b>	<b>1,531,203</b>	<b>1,780,305</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,606,803	1,755,509	1,752,549	1,531,203	1,780,305

Buxheti final në raport buxhetin fillestar ishte rritur për 148,706€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë si dhe rishikimit të buxhetit.

Në vitin 2016, MeD ka përdorur 100% të buxhet final. Nivel të ngjashëm të realizimit kishte edhe në vitin 2015.

**Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,606,803</b>	<b>1,755,509</b>	<b>1,752,549</b>	<b>1,531,203</b>	<b>1,780,305</b>
Pagat dhe Mëditjet	458,989€	478,803	476,868	424,884	397,123
Mallrat dhe Shërbimet	992,314	1,135,705	1,135,696	969,212	1,231,283
Shërbimet komunale	25,500	11,000	9,984	9,718	8,825
Subvencionet dhe Transferet	130,000	130,000	130,000	127,389	143,074

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte rritur për 19,814€ me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për dy Zëvendësministra të emëruar nga Qeveria;
- Buxheti për mallra dhe shërbime në total është rritur për 143,391€. Kjo ka ardhur si rezultat i mjeteve të ndara gjatë vitit nga Qeveria për projektin “Regjistri i Diasporës” në vlerë prej 200,000€ si dhe tranferit nga buxheti për shërbimet komunale në vlerë prej 14,500€. Përderisa në anën tjetër i njëjti buxhet ishte reduktuar me vendim të Qeverisë për kursime, për 71,109€; dhe
- Buxheti për komunalitet ishte reduktuar për 14,500€. Kjo shumë ishte alokuar për mallra dhe shërbime.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

---

## Çështja 5 – Mungesa e respektimit të ndarjeve buxhetore – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Sipas ligjit të buxhetit, për çdo kategori dhe nënkategori duhet të parashihet buxheti që do të shpenzohet gjatë një viti fiskal. MeD gjatë vitit 2016, në kodin buxhetor “Shpenzime të udhëtimit jashtë vendit” kishte tejkalluar limitin e planifikuar për këtë nënkategori. Kjo kishte ardhur si rezultat i aktiviteteve të shtuara të organizuara në diasporë. Mbishpenzimi i një nënkategorie të caktuar vë në pah planifikimin e dobët të aktiviteteve dhe shpenzimeve.
- Rreziku** Kjo rrit rrezikun që aktivitete tjera të planifikuara të mos realizohen duke pamundësuar arritjen e objektivave të paracaktuara.
- Rekomandimi 5** Ministri duhet të sigurojë se mjetet po shpenzohen për qëllimet e dedikuara bazuar në limitet buxhetore të përcaktuara për secilën nënkategori. Procesi i vlerësimit dhe planifikimit të buxhetit duhet të pasqyrojë tërë informacionin e duhur për nevojat vjetore të pritura, duke marrë në konsideratë parametrat dhe rezultatet paraprake.

### 3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel të MeD-së kanë të bëjnë me verifikimin e ndryshimeve të mundshme dhe azhurnimin e listës së pagave, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Testimi ynë ka nxjerr në pah disa dobësi në çështjet e paraqitura në vijim:

---

## Çështja 6 – Marrëveshjet për shërbime të veçanta – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Me Ligjin për shërbyesit civil nuk lejohet punësimi përmes “Marrëveshje për shërbime të veçanta” më gjatë se 6 muaj. Emërimet në raste të tilla do të bëhen duke ju nënshtruar Ligjit për Detyrimet, për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. MeD në vitet e kaluara kishte themeluar Qendrat Kulturore në Diasporë me vendim të Qeverisë, drejtorët e këtyre qendrave ende paguheshin nga mallrat dhe shërbimet për shkak të mos aprovimit të kërkesës buxhetore nga MF për futjen e tyre në buxhet për paga dhe mëditje. Pagesat e dy drejtorëve për vitin 2016 kishte qenë 48,682€.
- Rreziku** Praktika e lidhjes së kontratave me marrëveshje për shërbime të veçanta, pa procedura të rekrutimit, nuk siguron konkurrencë dhe transparencë dhe shton rrezikun për përzgjedhjen e kandidatëve pa shkathtësitë dhe përvojat e duhura profesionale.



- 
- Rekomandimi 6** Ministri duhet të siguroj se janë marrë veprime për të ndërprerë praktikat e angazhimeve/rekrutimeve të tilla në mungesë të procedurave, si dhe të evitohen pagesat e tyre në kundërshtim me ligjet. Njëherit, duhet siguruar se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje të përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, si dhe të gjitha pagat e tyre të kalojnë përmes listës së pagave.<sup>7</sup> – Mbajtja e pozitës me ushtrues detyre përtej afatit ligjor – Prioritet i mesëm
- E gjetura** Neni 30 i Ligjit për Shsërbimin Civil përcakton që asnjë pozitë nuk mund të mbahet me ushtrues detyre më tepër se tre (3) muaj. Gjatë auditimit kemi vërejtur se një (1) pozitë menaxhuese mbahet me ushtrues detyre prej muajit dhjetor 2015. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos përputhshmërisë së Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës me Ligjin e buxhetit dhe me Rregulloren Nr.02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive<sup>3</sup>. Ndryshimet vërehen në numrin e të punësuarve në kabinetin e ministrit, por kjo nuk reflekton në totalin për organizatën.
- E gjetura** Mbajtja e pozitës me ushtrues detyre më tepër se tre (3) muaj nuk siguron se detyrat po realizohen me kompetencë dhe përgjegjësi të plotë.
- Rekomandimi 7** Ministri duhet të negociojë me MF-në, për të siguruar buxhet shtesë për paga dhe mëditje në administratë konform rregullores për sistematizimin e vendeve të punës. Me pas të zhvillohen procedurat e rekrutimit për mbulimin e pozitave të përcaktuara.

---

<sup>3</sup> Në rregulloren për sistematizim në MeD, ishin të planifikuar 11 punonjës në Kabinet dhe 55 në Administratë (total 66). Në Rreg 02/2011 caktohet numri përcjellës për çdo Ministër dhe Zëvendesministër, që për MeD llogaritej të jetë 17 punonjës, dhe pjesa tjetër prej 49 kishte mbetur për administratë (total 66).

---



### 3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 1,135,705€. Gjatë vitit 2016 ishin shpenzuar 1,135,696€, ose 100% e buxhetit. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shpenzimet përmes procesit të prokurimit dhe ato pa proces të prokurimit (avancet, komunalitë, etj.).

Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit.

Bazuar në testet tona konkludojmë se realizimi i procedurave të prokurimit publik ishte në përputhje me rregullat e përcaktuara për prokurimin publik. Lidhja e kontratave me OE ishte menaxhuar në përputhje me kërkesat ligjore, ndërsa sa i përket testimit substancial janë vërejtur mangësitë në vijim:

#### Çështja 8 - Lidhja e marrëveshjes pa u respektuar procedurat e parapara me ligj - Prioritet i lartë

**E gjetura** Ligji i Buxhetit për vitin 2016, neni 12 parasheh që organizatat buxhetore mund të paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale deri në maksimumin e 15% të vlerës së kontratës, ndërsa për vlera më të mëdha duhet të kërkohet aprovimi i qeverisë (deri në 30%) dhe i kuvendit (100%). I vetmi rast kur mund të anashkalohen procedurat e mësipërme janë rastet të cilat trajtohen përmes Ligjit Nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare .

MeD kishte lidhur marrëveshje bashkëfinancimi me UNDP-në, për projektin “Fushata sensibilizuese e regjistrimit të diasporës dhe mërgatës”<sup>4</sup> pa u respektuar procedurat e përcaktuara nga ligjet e mësipërme. Vlera e kontratës ishte 75,000€, ku sipas marrëveshjes e gjithë vlera ishte paguar në avans. Çertifikuesi kishte njoftuar se pagesa e tillë, nuk është në përputhje me kornizën ligjore, mirëpo edhe përkundër kësaj menaxhmenti kishte vazhduar më tutje. Arsyeja e vazhdimit ishte, zotimi i UNDP-së për kontribuar me mjete të veta në këtë projekt.

**Rreziku** Dhënia e mjeteve si parapagim krijon pa siguri të mjaftueshme nëse marrëveshja do të realizohet dhe rrit rrezikun që Ministria të mos sigurojë evidencë të plotë të shpenzimit për mjetet e dhëna. Ndërsa, shmangia e procesit të tenderimit për realizimin e këtyre shpenzimeve, rrezikon arritjen e vlerës më të mirë për paratë e shpenzuar.

**Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë se të gjitha pagesat ekzekutohen vetëm pasi të janë marrë parasysh të gjitha kërkesat ligjore. Në këtë mënyrë do të sigurohej transparencë dhe kontroll më kualitativ i shpenzimit të parasë publike.

<sup>4</sup> Në plan të prokurimit ishte paraparë që të zhvillohen procedurat për këtë projekt në muajin shkurt 2016.

---

**Çështja 9 - Blerja e aviobiletave pa kaluar përmes departamentit të prokurimit - Prioritet i mesëm**

- E gjetura** MeD nuk kishte kontratë për shërbimet e udhëtimit jashtë vendit dhe ishte udhëzuar që mos të zhvillojnë procedura meqenëse ishte në pritje nënshkrimi i kontratës së centralizuar nga AQP. Gjatë nëntë muajve MeD kishte pranuar ofertë për secilën aviobiletë të kërkuar, mirëpo këto procedura nuk ishin zhvilluar përmes zyrës së prokurimit, por ishte caktuar një zyrtar tjetër për të marrë ofertat për secilën aviobiletë. Kjo kishte ndodhur për shkak të numrit të madh të kërkesave dhe ngarkesës që kishte zyra e prokurimit. Shuma totale e pagesave kishte qenë 41,314€. Megjithatë, kjo praktikë ishte ndaluar me 01.10.2016, kur kishte filluar përdorimi i kontratës nga AQP-ja.
- Rreziku** Blerja e biletave të shërbimeve të udhëtimit nga të punësuarit jashtë departamentit të prokurimit, rrit rrezikun e mos përfilljes së kërkesave ligjore, si pasojë e mungesës së trajnimeve për fushën e prokurimit.
- Rekomandimi 9** Ministri duhet të sigurojë se për të gjitha blerjet për të cilat kërkohet të zhvillohen procedura të prokurimit, të kalojnë përmes Departamentit të Prokurimit.

**Çështja 10 -Vonesat në mbyllje të avanseve për udhëtime - Prioritet i mesëm**

- E gjetura** UA2004/07 për udhëtime zyrtare neni 8 specifikon se avanset duhet të mbyllen 15 ditë pas kthimit nga udhëtimi zyrtar, përndryshe një kërkesë e tillë refuzohet.
- Në vërejtëm se dy avanse në shume totale 5,336€, nuk ishin arsyetuar edhe pse kishin kaluar disa muaj pas përfundimit të udhëtimit. Zyrtari Kryesor Financiar i kishte raportuar këto vonesa dhe kishte bërë kërkesë për mbylljen e tyre, mirëpo edhe përkundër kësaj avancet kishin mbetur të hapura.
- Megjithatë, pas dorëzimit të memorandumit të auditimit për fazën e ndërmjetme, në të cilin këshilluam menaxhmentin të përmirësojë menaxhimin e avanseve, avancet në fjalë ishin mbyllur.
- Rreziku** Mungesa e kontroleve efektive në mbylljen e avanseve rrit rrezikun që mjetet mos t'i kthehen ministrisë dhe të shfrytëzohen në mënyrë të jashtëligjshme.
- Rekomandimi 10** Ministri duhet të sigurojë se shpenzimet për udhëtime zyrtare menaxhohen në përputhje të plotë me legjislacionin. Në rast mos respektimit të afateve të merren masat e përcaktuara.

---

### 3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti për subvencione kishte për qëllim përkrahjen e projekteve të cilat ndikojnë në përafrimin e diasporës me shtetin e Kosovës.

Gjatë testimit të subvencioneve kemi vërejtur disa mangësi në kontrollet e zbatuara në procesin e arsyetimit (raportimit) nga ana e përfituesve.

---

#### Çështja 11 – Monitorim i dobët i shpenzimeve të subvencioneve - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Rregullorja nr. 1/2016 për kriteret dhe mënyrën e subvencionimit të projekteve për Diasporën, si dhe neni 5 i Marrëveshjeve për Subvencionim, përcakton se në afat prej 30 ditësh nga përfundimi i projektit, përfituesi i dorëzon zyrtarit monitorues raportin, kurse neni 12 thekson se nëse bartësi i realizmit të projektit nuk dorëzon arsyetimin brenda afatit, MeD mund të kërkojë kthimin e mjeteve të marra, madje me kamatë ligjore.

Në shtatë (7) raste kemi evidentuar se përfituesit e subvencioneve nuk kishin raportuar brenda afatit të përcaktuar, ku vonesat varionin deri në katër muaj. Megjithatë, në asnjë rast nuk kemi parë të jenë marrë masa konform rregullores. Megjithatë, MeD kishte përpiluar një listë me personat/subjektet të cilët nuk e kanë respektuar marrëveshjen, si evidencë që në të ardhmen të mos u lejohet përfitimi i subvencioneve nga Ministria.

**Rreziku** Vonesat në raportimin dhe arsyetimin e subvencioneve rrezikojnë që MeD të mos jetë e informuar në kohë lidhur me zhvillimin e projekteve të cilat i ndihmojnë në arritjen e objektivave të saj. Po ashtu, këto vonesa rrisin rrezikun që mjetet të mos përdoren për qëllimet e përcaktuara.

**Rekomandimi 11** Ministri duhet të sigurojë se të gjithë zyrtarët e involvuar në procesin e dhënies së subvencioneve, të respektojnë kërkesat e përcaktuara ligjore për menaxhimin e subvencioneve. Në rast të nevojës të mbahen trajnime për stafin, për të vepruar konform kërkesave të përcaktuara. Kjo do t'i hapte rrugë një procesi më kualitativ të monitorimit të tyre.

### 3.1.4 Pasuritë

Vlera e përgjithshme e pasurisë kapitale në PVF për vitin 2016 ishte 64,000€, ndërsa vlera e pasurisë jokapitale ishte 70,000 €. Vlera e stokeve në fund të vitit 2016 ishte 20,000€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores së MF 02/2013 për menaxhimin e pasurisë qeveritare, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive. Bazuar në këtë konkludojmë se pasuritë ishin menaxhuar në harmoni me kërkesat.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.2 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2016 ishte në vlerë 23,773€. Këto detyrime janë bartur për tu paguar në vitin 2017.

Ne kemi kryer teste lidhur me obligimet në fund të vitit si dhe ato të raportuara në raportet mujore. Bazuar në këtë konkludojmë se MeD ka krijuar një sistem të mirë të menaxhimit të dhe raportimit të obligimeve, në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara ligjore.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Implementimi i rekomandimeve	Ministri duhet të sigurojë që është monitoruar në mënyrë formale dhe zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve.			Nuk janë marrë masa.
Lista kontrolluese e vet-vlerësimit	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vet-vlerësimit, posaçërisht në fushën e menaxhimit të rrezikut. Të sigurohet se gjatë procesit të hartimit të strategjisë së re fillimisht të sigurohen fonde pastaj të vazhdohet me aprovim të strategjisë.		Lista kontrolluese ishte plotësuar, megjithatë mungonte regjistri i rrezikut si dhe raportimi menaxherial nuk ishin në nivel të duhur.	
Vlerësimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për hartimin e listës për menaxhimin e rrezikut tek pozitat përkatëse me një monitorim nga ana e ZKA-së.		MeD kishte iniciuar një proces për përgatitjen e regjistrit të rrezikut megjithatë nuk ishte finalizuar ky proces.	
Raportimi menaxherial	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, ku secili menaxher monitoron dhe raporton për aktivitetet në drejtim të objektivave dhe buxhetin e ndarë për njësinë relevante.			Nuk janë marrë masa.
Shpenzimet përmes prokurimit	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha blerjet apo shërbimet, të kontraktohen në përputhje me kërkesat e LPP-së, dhe të gjitha pagesat ekzekutohen në përputhje me ligjin dhe rregulloret përkatëse.			Nuk janë marrë masa.

Shpenzimet jo-përmes prokurimit	Ministri të sigurojë se marrëveshjet janë nënshkruar vetëm pasi janë marrë parasysh të gjitha kërkesat ligjore për t'u arritur marrëveshje me palët e jashtme. Poashtu të gjitha pagesat të ekzekutohen në përputhje me ligjin. Kjo do të sigurojë kontroll më efektiv nga MeD dhe të ketë shërbime të cilësisë së lartë me çmime më të favorshme.			Nuk janë marrë masa.
Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se subvencionet iu ipen përfitueseve të pranueshëm të cilët i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara me rregullore të brendshme dhe këtë e dëshmojnë me dokumentacionin përkatës. Si dhe të shtojë masat e kontrollit rreth monitorimit të projekteve të subvencionuara në mënyrë që raportet nga përfituesit të jenë të rregullta.		Në proces të adresimit. Edhe në vitin 2016 janë identifikuar disa vonesa në raportim nga ana e përfituesve.	
Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të rishikoj efikasitetin e procesit të vendosur për menaxhimin e subvencioneve. Vendimet për dhënien e subvencioneve të identifikojnë qartazi aktivitetet konkrete të përfitueseve për të cilat jepen ato subvencione. Kjo do të lehtësonte procesin e raportimit nga ana e përfituesëve si dhe monitorimin e tyre nga ana e Ministrisë. Gjithashtu edhe përgatitja e raporteve nga nëpunësit rreth pjesëmarrjes në aktivitetet e organizuara nga MeD-ja do të jepte një pasqyrë të saktë rreth efektit që kanë këto lloj organizimesh.	Po		
Pasuritë	Ministri të sigurojë se mbahen regjistra të plotë dhe të saktë të pasurisë jo-financiare nën 1,000€, si dhe gjendja e stoqeve në depo të jetë e njëjtë me raportet gjatë numërimit fizik të tyre.	Po		

## Shtojca IV: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E DIJASPORËS / MINISTARSTVO ZA DIJASPORU / MINISTRY OF DIASPORA			REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE	
Adresa Org. Org. address Org. code: <u>02</u>	Nr. i Prot. Brev. Prot. Prot. No: <u>722</u>		Data Datum Date: <u>16.05.2017</u>	
Nr. i Fajesit No. of Pages No. Pages: <u>01</u>	Prinditë / u Parents: / u		Nr. i Prot. Brev. Prot. Prot. No: <u>16.05.2017</u>	
		Nr. i Prot. Brev. Prot. Prot. No: <u>21</u>	Nr. i Prot. Brev. Prot. Prot. No: <u>21.23</u>	Nr. i Prot. Brev. Prot. Prot. No: <u>524</u>
				Nr. i Prot. Brev. Prot. Prot. No: <u>1</u>

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Diasporës/Ministarstvo za Dijasporu/Ministry of Diaspora**  
*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Ured Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General*

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Diasporës për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Osman Shahini, .....

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Diasporës

Data: 16.05.2017

